



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.127/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (VV), dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatëve në hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, me të cilën kërkohet që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Vetëvendosje(VV), dega në Pejë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes.

A r s y e t i m

Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, ka parashtruar ankesë në PZAP, më datën 06.10.2017, me të cilën pretendon se me datën 05.10.2017, zyrtarë të Shtabit Zgjedhor të LDK-së në Pejë, kanë vërejtur dhe fotografuar vendosjen e posterëve elektorale të kandidatëve të Vetëvendosjes (VV) për Kuvendin Komunal të Pejës, Sali Lukaj dhe Avdi Shkreli të vendosura në shtylla elektrike (në pronë dhe hapësirë publike) përgjatë rrugës “ Mbretëresha Teutë” në Pejë. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33, pika b), të LZP-së Ligji Nr. 03/L-073 dhe Rregullat zgjedhore të KQZ-së nr.11/2013 dhe 13/2013. Pretenduesi i ankesës potencon se vendosja e këtyre posterëve për qëllime të fushatës zgjedhore, është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat zgjedhore dhe përbën shkelje të këtyre dispozitave me propozim që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 07.10.2017, subjekti politik Vetëvendosje, nuk e mohon faktin se posterat në fjalë janë të vendosura në shtylla elektrike në rrugën **Mbretëresha Teutë**, në qytetin e Pejës por thekson se në bazë të provave të bashkangjitura në ankesë e vërtetojnë se vendosja e posterave në rrugën e lartcekur është bërë nga Kompania M-R FATI-SHPK pronarit Milaim Rama nga Zahaqi, i cili paraprakisht ka marrë leje nga Komuna e Pejës, konkretisht, nga Drejtoria për çështje Pronësore-Juridike e Komunës së Pejës, për vendosjen e panove reklamuese në shtylla të ndriçimit publik në rrugë të caktuara, duke përfshirë edhe Rrugën, Mbretëresha Teutë. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Përgjigjes në ankesë ia ka bashkangjitur Kërkesën për Vendosje e panove në rrugët të përshkruara në Vendim, përfshirë edhe rrugën **Mbretëresha Teutë**.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik VV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se vendosja e posterëve të kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal të Pejës nga radhët e subjektit politik Vetëvendosje janë të vendosura në vendin e dedikuar për vendosjen e posterëve dhe reklamave. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në ankesë në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL. Anr.127/2017 më datën 10.10.2017



Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haziri

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.